

VENDIM
Nr. 48, datë 18.8.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR PËRCAKTIMIN E
FATURIMIT AFORFE PËR PERIUDHËN E VITIT 2006**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.08.2006, pasi verifikoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria KESH sh.a., për përcaktimin e faturimit aforfe për periudhën e vitit 2006,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për përcaktimin e faturimit aforfe për periudhën e vitit 2006 për shoqërinë “KESH” sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e aplikimit të paraqitur nga shoqëria “KESH” sh.p.k. brenda afateve të përcaktuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta